Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0800
Data e Vendimit: 30.10.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "NEWCO GRATIS L.L.C." kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja - pastrimi i objekteve të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-26-6153-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prizrenit, Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 29. 10. 2026, mori këtë:

Vendim

I. Refuzohet si jo e plotë, ankesa e OE "Newco Gratis L.L.C." me nr. të protokollit 2026/0800, e datës 15.10.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja - pastrimi i objekteve të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-26-6153-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prizrenit, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prizrenit që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar dëshmi bankare për pagesën (nuk ka kryer pagesë) siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të Rregullores për prokurim publik 001/2022 si dhe nenin 118 te LPP-se.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 15.10.2026, ka pranuar ankesën Nr. 2026/0800 (Nr. protokolli) e OE "NEWCO GRATIS L.L.C." lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja - pastrimi i objekteve të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-26-6153-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Nga provat e administruara OSHP konstaton se me datën 28.07.2026 Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë B05.

Me datën 06.10.2026, OE "NEWCO GRATIS L.L.C."ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK, të cilën AK e ka refuzuar me datën 08.10.2026.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, është konstatuar se operatori ekonomik ankues nuk ka dorëzuar dëshmi bankare për pagesën (nuk ka kryer pagesë) siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të Rregullores për prokurim publik 001/2022 si dhe nenin 118 te LPP-se.

Nga OSHP, me datën 16.10.2026 përmes email-it zyrtar të OSHP-së është kërkuar nga OE ankues që brenda afatit ligjor të dorëzojë dëshmitë (verifikimin bankar) për kryerjen e pagesës, me paralajmërimin që nëse pagesa nuk kryhet ankesa do të refuzohet. Edhe përkundër email-it me njoftim të dërguar nga OSHP, OE ne fjale nuk i është përgjigjur kërkesës se OSHP-se për plotësim te ankesës- kryerjen e pagesës brenda afatit ligjor.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas te gjitha fakteve te analizuara sqaron se sipas nenit 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Poashtu sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: "1. *Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare. 2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet"*.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë jo të plotë siç parashihet me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së me saktësisht nenit 118 par 1 dhe 2 te LPP-se si dhe nenit 69 par 2 te Rregullores për Prokurim Publik, andaj mbi bazën e këtyre dispozitave ankesa e OE "Newco Gratis L.L.C." refuzohet si jo e plotë (nuk shqyrtohet) dhe i lejohet autoritetit kontraktues – Komuna e Prizrenit, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit të sipërcituar, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Kryesuesi i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ardian Behra
Kryesues i Sekretariatit

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **NEWCO GRATIS L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: